



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za žalbe i Predstavke



**ZL.Anr.136/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP) dega në Dragash, paraqitur kundër Haxhi Berisha, Zyrtar i lartë Komunal i zgjedhjeve, për shkak të parregullsive lidhur me caktimin e Komisionarëve në Vend Votim, për Zgjedhjet Lokal 2017, e që do të mbahen më 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

**HIDHET si e palejuar** ankesa ZL.Anr.136/2017 e datës 06.10.2017 e subjektit politik Jedinstvena Goranska Partija (JGP), dega në Dragash, lidhur me parregullsitë për caktimin e Komisionarëve në Vend Votimin, në Komunën e Dragashit.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 06.10.2017 nga Jedinstvena Goranska Partija (JGP) dega në Dragash me të cilën pretendon se në komunën e Dragashit ku jetojnë komuniteti goran, lidhur me rastin e caktimit të komisionarëve në vendvotime VV janë bërë parregullsi arbitrare nga ana e zyrtarit të lartë komunal të zgjedhjeve.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur Flet listën e anëtarëve të KVV-ve për Komunën e Dragashit

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:

### **Ankesa është e pa lejuar**

Paneli me rastin e vlerësimit të paanshmërisë së ankesës ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për tu shqyrtuar nga ana e PZAP-it, pasi që parashtruesi i ankesës paraprakisht është dashur ti drejtohet KQZ-së dhe pas vendimit të marrë nga KQZ-ja ti drejtohet PZAP-it për ta shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit lidhur me shkeljen e supozuar.

Mbi këtë bazë Paneli nuk u lëshuar në vlerësimin e pretendimeve ankimore të parashtruesit të ankesës përkitazi me parregullsitë e bëra në komunën e Dragashit, nga Zyrtari i lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZKLZ) me rastin e caktimit e numrit të komisionerëve në vendvotime VV, për faktin se, e drejta për paraqitjen e ankesës është e kufizuar në bazë të dispozitës së nenit 122.1 të LPZ-së, ku përcaktohet: “Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilat janë prekur nga cilat do vendime të mëposhtme, vendime këto të marra nga KQZ-ja mund të apelojë atë vendim në PZAP” dhe në rastin konkret një vendim i tillë i KQZ-së nuk egziston, pasi që parashtruesi i ankesës nuk është drejtuar me ankesë të veçant KQZ-së.

Paneli në kuptim të nenit 6.4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it (Rregullës nr. 02/2015) dhe nenit 118.1 të LQP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Zl.Anr. 136/2017 më datën 10.10.2017.



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LQP-